

24.12.2009, "ZERI"

Laboratori i ADN-së, pak gjasa për t'u sigruar

Një laboratori i ADN-së me peshë shumë më të madhe se **vlera reale e tij**, prolongohet në mënyrë të vazhdueshme nga institucionet

Afërdita Uka


PRISHTINË → Identifikimi i mbetjeve mortore të mijëra personave të zhdukur si pasojë e luftës në Kosovë, ka vité që është duke u bërë nëpërmes metodës më të sigurt shkencore asaj të ADN-së. Testin e ADN-së, si metodë që vazhdon të aplikohet për zbardhjen e identitetit të zhdukurve vazhdon ta kryejë Komisioni Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur (ICMP) pa kurfard kompensimi.

Sado që është thënë shpesh se kjo metodë përvetë që është shumë e kushtueshme kërkon edhe ekspertë përkatës, të cilët i mungojnë Kosovën, në rast te ngecjesë të procesit apo mungesës së rezultateve të prishme nuk kanë munguar edhe kritikat ndaj ICMP-së.

Zërat që kanë këruar më shumë rezultate dhe efikasitet janë shtuar sidomos pasi në morgan e Zyrës për të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore në Prishtinë, janë afro 400 mbetje mortore të pidentifikuara.

Pas presioneve dhe protestave të ndryshme të familjarëve të të zhdukurve, ka qenë vetë ministria e Drejtësisë ajo që ka paralajmëruar se do të shqyrtojnë mundësinë e sigurimit të një laboratori të ADN-së. Ministria, Nekube Kelmendi e vetëdijshme për rëndësinë që ka një laboratori i ADN-së jo vetëm për çështjen e personave të zhdukur, por edhe për mbarëvajtjen punës së gjykatave dhe për një shtet të ri si Kosova, thotë se duhet të bëjmë një laborator më të mirin në region.

"Posa ta sigurojmë atë para-prakisht duhet t'i drejtoheni Qeverisë, që të na lejojë të marrim staf t'ri", ka thënë ajo. Kelmendi thotë se tanimë janë bërë



paralogaritë për këtë laboratori, që mund të kushtojë 1 million e 200 mijë euro. Këto injete, ajo thotë se është zotuar se do t'i sigurojë zëvendëskryeministri Ramë Manaj, por tanë kjo çështje është heshtur. Madje, sipas saj, çështja e laboratorit të ADN-së imbetet një nga prioritetet e MD-së për vitin e ardhshëm.

Nga ana tjeter, sado që

autoritetet vendore shpesh janë ankuar se na mungojnë eksperët të profileve të ndryshme të mjekësisë ligjore, duke filluar nga ata për ADN-në, antropologët etj., ka shumë bashkatëtar, që me forcat e veta janë shkollluar jashë vendit, kanë arritur nivelet më të larta të titujve profesional e akademik dhe janë të gatshëm që të

ktethehen për të kontribuar në Kosovë. Një prej tyre është edhe dr. Rifat Morina, i cili ka magjistruar për biokimi molekulare në Lubjanë, ndërsa ka doktoruar për gjenetikë molekulare në Gjermani. Ndonëse vazhdimisht ka pasur një puñë të regjullt kërkimore shkencore, që i është paguar mirë ai ka shprehur gatishmëri që me gjithë mirëgenien ekonomike, që ka siguruar atje të braktisë të gjitha për t'u kthyer në Kosovë që të japë kontributin e tij, sidomos në çështjen e peronave të zhdu-

Kelmendi thotë se tanimë janë bërë paralogaritë për këtë laboratori, që mund të kushtojë 1 million e 200 mijë euro.

Kur. Këtë ai e konsideron jo vetëm si obligim profesional, por edhe si obligim familial e patriotik në shenjë nderimi e respektit për axhën e tij të zhdukur.

Me të ardhur në Kosovë, ku është ftuar nga dekani i Fakultetit të Mjekësisë në bashkëpunim me WUS-in për të mbajtur një cikël ligjératash për gjenetikë molekulare, ka pasur shumë oferta për punë nga institucionë shëndetësore private. Por, edhe sikut t'i ofrohet të punonte në laboratorin e mjekësisë ligjore në Policinë e Kosovës, ku ka punuar për një kohë të shkurtër pas luftës, ai thotë se sërisht do të zgjidhë që kontributin e tij ta jap për çështjen e të zhdukurve.

Ai është i bindur se sikur të ishte instaluar laboratori i ADN-së në vitin 2000, deri tanë do të kishim kuadro të trajnuara, do të ishte zgjidhur problemi i të pagjeturve dhe këto analiza do të bëhen nëpërmjet 70 përfundimit më të lirë.